



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:084407

Datë: 30.07.2019

Numri i dokumentit: 00433428

**C.nr.242/19**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil** me gjyqtaren Afijete Sada-Gllogjani dhe sekretarja juridike Vjollca Gaxha, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses K.K. per D. dhe F. me E.E. Sh.a (K.) Prishtinë, kundër të paditurit M.K.D., Komuna e Gjakovës, për kompensim dëmi material, vlera e kontestit 380.09€, pa shqyrtim të mëtejme me datë 26 korrik 2019, murr këtë;

### **A K T G J Y K I M PËR SHKAK TË MOSBINDJES**

**APROVOHET** kërkesë-padia e paditëses K.K. per D. dhe F. me E.E. Sh.a (K.) Prishtinë dhe **DETYROHET** i padituri M.K.D. Komuna e Gjakovës që paditëses të ia paguaj dëmin e shkaktuar material në shumën prej 380.09€ ( treqindetëdhjetë euro e nëntë cent ) me kamatë ligjore 8% duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë ( 29 mars 2019) gjer në pagesën definitive dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 20.00 € ( njëzet euro) në afat prej 7 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit.

### **A r s y e t i m**

Paditësja ka parashtruar padi pranë kësaj Gjykate me datë 29 mars 2019, kundër të paditurit për kompensimin e dëmit material në shumë 380.09€. Në referat të padisë është shënuar se i padituri deri 15 dhjetor 2014 dhe pas asaj date edhe një herë deri me 19 dhjetor 2015 me qëllim që vetit ti sjelli pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ashtu që jashtë njëisorit elektrik për mes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik, me ato veprime energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar. Me atë rast të paditurës i është shkaktuar dëm në shumë prej 380.09 €. Shumë e llogaritur në pajtueshmëri me Rregulloren në fuqi "Procedura për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të pa autorizuarit të energjisë elektrike" të miratuar nga ZRRE me datë 21 korrik 2009, neni 13 dhe 14.

Sipas Aktgjykimit penale të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.673/2016 datë 06 mars 2017 i padituri është shpall fajtor, për shkak të kryerjes së veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të Kodit Penal të Kosovës, përderisa e dëmtuara tani paditësja për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale është udhëzuar në kontest civil.

Sipas nenit 394 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, Gjykata me aktvendimin C.nr.242/19 të datës 25 prill 2019, ka kërkuar përgjigjen e detyrueshme në padi nga ana e të paditurit.

Nga fletë kthesa në lëndë konstatohet se Aktvendimi për përgjigje në padi i është dorëzuar të paditurit me datë 14 maj 2019, i njëjti në afatin prej 15 ditë pas pranimit të aktvendimit nuk ka dhënë përgjigje në padi.

I padituri brenda afatit të përcaktuar me Ligjin e lartë shënuar nuk i ka paraqitur Gjykatës përgjigje në padi, bazuar në nenin 150.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ky Aktgjykim u murr për shkak të pa dëgjueshmërisë përkatësisht mos bindjes, sepse janë plotësuar këto kushte; a) të paditurit padia dhe Aktvendimi për të dhënë përgjigje në padi i është dorëzuar në mënyrë të rregullt, b) themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e parashtruara në padi dhe c) faktet mbi të cilat mbështet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë pala paditëse.

Pala e paditur detyrohet të paguajë shpenzimet procedurale për taksë gjyqësore palës paditëse në shumë prej 25.00 € sipas nenit 452 të LPK-së.

Bazuar në nenin 160.6 të njëjtit Ligj janë dhënë arsyet që e arsyetojnë dhënien e këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**C.nr. 242/19, Datë 26 korrik 2019**

**Gj y q t a r j a,**  
**Afijete Sada-Gllogjani**

**UDHËZIM JURIDIK ;** Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së tij Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2019:084407  
Datë: 30.07.2019  
Numri i dokumentit: 00433428